



Funded by
the European Union



THIRRJE E HAPUR PËR PROPOZIME

Udhëzues për Aplikantët

Autoriteti Kontraktor: Together for Life (TFL)
Në partneritet me: BIRN Albania, Qëndresa Qytetare dhe Destiny
Center for Excellence

**Titulli: Faza 1 – Nën-grante SPACE për të mbështetur
OSHC-të lokale që veprojnë në sektorët e shëndetësisë dhe
arsimit**

Numri i referencës së kontratës të grantit: IPA III/2022/441-234

“Mbështesim pjesëmarrjen, llogaridhënien dhe fuqizimin e shoqërisë civile” (SPACE)

Afati për dorëzimin e aplikimeve: 19 Dhjetor 2023, ora 17.00



TABELA E PËRMBAJTJES

1. SKEMA E NËN-GRANTEVE PROJEKTI SPACE

1.1 Përmbledhje	3
1.2 Objektivi i thirrjes për propozime dhe prioritetet	3
1.3 Alokimi financiar i siguruar nga autoriteti kontraktues	4

2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROPOZIME..... 4

2.1 Kriteret e pranueshmërisë 4 |

2.1.1 Pranueshmëria e aplikantëve.....	4
--	---

2.1.2 Aktivitetet e pranueshme	5
--------------------------------------	---

2.1.3 Pranueshmëria e shpenzimeve	6
---	---

2.2 Si të aplikoni dhe procedurat që duhet të ndiqni 7 |

2.2.1 Dërgimi i aplikimit	7
---------------------------------	---

2.2.2 Dokumentat mbështetëse	8
------------------------------------	---

2.2.3 Ku dhe si ta dërgoni aplikimin	8
--	---

2.2.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikimit	9
---	---

2.2.5 Informacione të tjera rreth aplikimit	9
---	---

2.3 Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve 9 |

Hapi 1: Kontrolli administrativ.....	9
--------------------------------------	---

Hapi 2: Vlerësimi i aplikimeve	10
--------------------------------------	----

Hapi 3: Vlerësimi final dhe marrja e vendimit	11
---	----

Hapi 4: Njoftim mbi vendimin e autoritetet nën-grantues	11
---	----

3. AFATET INDIKATIVE TË PROCESIT..... 12

Lista e Anekseve.....	13
-----------------------	----

1. SKEMA E NËN -GRANTEVE PROJEKTI SPACE

1.1. PËRMBLEDHJA

Shoqata “Together for life”, në bashkëpunim me BIRN Albania, Qëndresa Qytetare dhe Destiny Center for Excellence, po zbatojnë projektin “Mbështesim pjesëmarrjen, llogaridhënien dhe fuqizimin e shoqërisë civile” (SPACE). Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian, referenca: EuropeAid/174080/DD/ACT/.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të forcojë angazhimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në proceset/ ciklin e politikave publike përmes avokimit të bazuar në të dhëna dhe monitorimit të reformave.

Kjo do të arrihet nëpërmjet: a) përmirësimit të kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për t'u angazhuar si aktorë të qeverisjes; b) monitorimin e funksionimit të qeverisë, shprehjen e shqetësimeve dhe promovimin e llogaridhënies në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit; c) rritja e bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve, mediave, rinisë, palëve të interesuara shtetërore/ joshtetërore për transparencën dhe llogaridhënien në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit.

Nëpërmjet aktiviteteve të ndërmarra si pjesë e këtij projekti, pritet që organizatat lokale të shoqërisë civile të punojnë më mirë së bashku për të kërkuar rritjen e llogaridhënies dhe transparencës buxhetore nga institucionet publike në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit; Presioni publik ndaj autoriteteve për të reaguar, për të ndryshuar sjelljen dhe për të reduktuar korrupsionin do të rritet dhe OSHC-të, media, të rinjtë, palët e interesuara shtetërore/ joshtetërore do të punojnë së bashku për të përmirësuar transparencën buxhetore dhe llogaridhënien, duke mundësuar shërbime sa më cilësore për qytetarët shqiptarë.

Skema e nëngranteve përbën një komponent jetik të projektit SPACE dhe do të jetë **e ndarë në dy faza**. Kjo thirrje e hapur për projekt propozime është pjesë e raundit të parë të skemës së nën-granteve dhe synon të mbështesë deri në 6 organizata të shoqërisë civile nga rajone të ndryshme të vendit. *OShC-të që dalin fituese në raundin e parë të skemës së nën-granteve, do të mbeten të pranueshme për të riaplikuar në raundin e dytë të thirrjes për propozime.*

Organizatat fituese pritet të zbatojnë projekte që monitorojnë, avokojnë dhe rrisin ndërgjegjësimin për një qeverisje më të mirë në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit. ***Prioritet do t'u jepet organizatave të vogla lokale, duke synuar fuqizimin e tyre për të kryer sa më mirë rolin mbikëqyrës, në mbrojtje të interesave të komunitetit dhe transmetimit të zërit të tij.*** Organizatat inkurajohen të zhvillojnë plane lokale advokuese për të përmirësuar llogaridhënien dhe transparencën e institucioneve publike në nivel lokal.

1.2 OBJEKTIVI I THIRRJES PËR PROPOZIME

Objektivi specifik i kësaj Thirrje për Propozime është të ofrojë mbështetje financiare për OSHC-të e vogla lokale, nga rajone të ndryshme të Shqipërisë, duke ju dhënë atyre mundësinë të nxisin transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike lokale në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit, duke punuar paralelisht drejt avokimit dhe ndryshimit.

Rezultatet e pritshme të kësaj thirrje për propozime janë: (a) OSHC-të e vogla lokale të afta të rrisin presionin ndaj autoriteteve publike për të reduktuar korrupsionin në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit; (b) Qytetarët shqiptarë marrin shërbime më cilësore në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, për shkak të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike në nivel lokal.

1.3 ALOKIMI FINANCIAR I SIGURUAR NGA AUTORITETI KONTRAKTUES

Buxheti total indikativ i disponueshëm për këtë thirrje për propozime:	45.000 EUR
<i>Shuma minimale e kontributit për projekt:</i>	6000 EUR
<i>Shuma maksimale e kontributit për projekt :</i>	9000 EUR
<i>Mbulimi i kostove:</i>	Skema e nën-granteve do të mbulojë 100% të kostove të pranueshme .
<i>Kohëzgjatja e projektit:</i>	Min. 6 muaj Max. 9 muaj
<i>Vendi i zbatimit të projektit:</i>	Shqipëri

2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROPOZIME

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për aplikimin, përzgjedhjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga kjo thirrje, në përputhje me udhëzuesin praktik, i cili është i zbatueshëm për këtë thirrje (<https://wikis.ec.europa.eu/display/ExactExternalwiki/ePRAG>).

2.1 KRITERET E PRANUESHMËRISË

2.1.1 Pranueshmëria e aplikantëve (aplikanti kryesor dhe bashkë-aplikuesi(ët))

Për t'u kualifikuar për një nën-grant, aplikanti kryesor duhet:

- të jetë një organizatë joqeveritare, organizatë lokale e shoqërisë civile e regjistruar dhe që vepron ligjërisht në territorin e Shqipërisë;
- të jetë jofitimprurëse;
- të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit me bashkë-aplikuesit (nëse ka), duke mos vepruar si ndërmjetës;

Aplikantët kryesorë duhet të nënshkruajnë Deklaratën e Aplikantit Kryesor (Aneksi 3). Aplikanti kryesor mund të aplikojë për këtë thirrje vetëm ose me bashkë-aplikues. *Bashkëpunimi ndërmjet OSHC-ve lokale inkurajohet në këtë thirrje për propozime, duke i dhënë përparësi partneriteteve.*

Bashkë-aplikuesit (nëse ka) duhet të plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të njëjta me aplikantin kryesor. Bashkë-aplikuesit duhet të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e projektit dhe kostot e tyre janë njëlloj të pranueshme me ato të bëra nga aplikanti kryesor. Nëse nënshkruhet kontrata e grantit, bashkë-aplikuesi(ët) (nëse ka) do të bëhen përfitues (të) në projekt. Bashkë-aplikuesit duhet të nënshkruajnë Mandatin (Aneksi 4).

Nëse përzgjidhet si fitues i nën-grantit, aplikanti kryesor do të bëhet përfituesi i identifikuar si koordinator në Kushtet e Veçanta (Kontakti kryesor për Nën-Grantin). Koordinatori është bashkëbiseduesi i vetëm i autoritetit kontraktor. Ai përfaqëson dhe vepron në emër të çdo bashkëpërfituesi tjetër (nëse ka) dhe koordinon hartimin dhe zbatimin e projektit.

Aplikanti nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikim për këtë Thirrje për Propozime. Aplikanti nuk mund të jetë bashkë-aplikues ose subjekt në një aplikim tjetër në të njëjtën kohë.

2.1.2 Aktivitetet e pranueshme

Aktivitetet e propozuara për këtë thirrje për propozime duhet të fokusohen në arritjen e rezultateve bazuar në objektivin e përcaktuar në seksionin 1 të këtij dokumenti.

Lloji i aktiviteteve të sugjeruara - jo shteruese.

- Monitorimi, analizimi i planeve vendore për sektorët e shëndetësisë apo arsimit.
- Monitorimi i cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit lokal në sektorët e shëndetësisë apo arsimit.
- Nisma avokuese që nxisin ndryshime në politikat/ legjislativet e qeverisjes vendore.
- Përgatitja e planeve të advokimit për të përmirësuar cilësinë e shërbimit ndaj komunitetit lokal në sektorët e shëndetësisë apo arsimit.
- Aktivitete ndërgjegjësuese për të drejtat e komunitetit në sektorin e shëndetësisë apo arsimit duke përfshirë të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave.
- Aktivitete që nxisin konsultimet publike.
- Rritja e presionit ndaj autoriteteve publike për më shumë transparencë dhe llogaridhënie.

Gjatë zbatimit të projektit, autoriteti kontraktues (TFL) do të sigurojë për nën-grantuesit fitues:

- Trajnime për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e projektit dhe avokim/ rritje ndërgjegjësimi.
- Mbështetje teknike/ mentorim gjatë zbatimit të projektit.

Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për mbështetje financiare:

- Aktivitete që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me sponsorizime individuale për pjesëmarrje në ëorkshop, seminare, konferenca, kongrese;
- Aktivitete që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me bursa individuale për studime ose kurse trajnimi;
- Projektet që përbëhen tërësisht, ose në pjesën më të madhe nga punime ose studime përgatitore;
- Projektet që mbështesin partitë politike apo aktivitetet ilegale dhe aktivitetet fetare;
- Financimi i deficitit dhe fondeve kapitale;
- Aktivitete të ndërmarra para nënshkrimit të kontratës së grantit;
- Aktivitete që synojnë aktivitete fitimprurëse;
- Aktivitete që lidhen me donacione bamirëse;
- Subvencione financiare për organizata të tjera;
- Blerja e tokës, ndërtesave dhe zyrave/ Renovimi i ndërtesave ose zyrave;
- Financim retroaktiv për projektet që janë tashmë në zbatim ose të përfunduara;
- Aktivitete që zhvillohen jashtë Shqipërisë;

Vizibiliteti

Aplikantët duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të bërë publike faktin se Bashkimi Evropian po financon projektin përmes projektit “**Mbështetje për Pjesëmarrjen, Përgjegjshmërinë dhe Fuqizimin e Shoqërisë Civile**” (SPACE), i zbatuar nga një konsorcium organizatash i drejtuar nga Together for Life. Propozimet që financohen tërësisht ose pjesërisht nga Bashkimi Evropian duhet të sigurojnë vizibilitetin e financimit të BE-së duke përdorur logon e BE-së në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në Udhëzimet Operacionale për përfituesit e fondeve të BE-së, të publikuara nga Komisioni Evropian. Nëse është e aplikueshme, mund të ndërmerren aktivitete komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin e audiencës specifike ose të përgjithshme për qëllimet e projektit dhe mbështetjen e BE-së për projektin në vendin ose rajonin në fjalë, si dhe rezultatet dhe ndikimin e kësaj mbështetjeje.

Të gjitha masat dhe aktivitetet në lidhje me vizibilitetin dhe, nëse është e aplikueshme, komunikimin, duhet të jenë në përputhje me Kërkesat më të fundit të Komunikimit dhe Vizibilitetit për veprimet e jashtme të financuara nga BE, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni Evropian ([Communication and Visibility Requirements for EU External Actions | International Partnerships \(europa.eu\)](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_18_111)).

2.1.3 Pranueshmëria e kostove

Vetëm "kostot e pranueshme" mund të mbulohen nga një nëngrant. Kategoritë e kostove që janë të pranueshme dhe të papranueshme janë treguar më poshtë. Buxheti është njëkohësisht një



vlërësim i koston dhe një tavan i përgjithshëm për "koston e pranueshme".

Në fazën e kontraktimit, Autoriteti Kontraktor vendos nëse do të pranojë shumat e propozuara në buxhetin provizor të paraqitur nga aplikantët, duke analizuar të dhënat faktike të granteve të kryera nga aplikuesit ose projekte të ngjashme.

Rekomandimet për dhënien e një nëngranti gjithmonë i nënshtrohen kushtit që kontrollet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës së nëngrantit të mos zbulojnë probleme që kërkojnë ndryshime në buxhet të tilla si gabime aritmetike, pasaktësi, kosto joreale dhe kosto të papërshtatshme. Kontrollet mund të sjellin kërkesa për sqarime dhe mund të bëjnë që autoriteti kontraktor të vendosë modifikime ose reduktime për të adresuar gabime ose pasaktësi të tilla. Nuk është e mundur të rritet granti ose përqindja e financimit si rezultat i këtyre korrigjimeve.

Koston direkte të pranueshme janë koston aktuale të bëra nga aplikantët të cilat plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- ato kanë ndodhur gjatë zbatimit të projektit;
- kosto që lidhën me shërbime dhe punë duhet të përkohjnë me aktivitete të kryera gjatë periudhës së zbatimit të projektit;
- koston e kryera duhet të paguhen përpara datës së mbylljes së projektit;
- ato janë të pasqyruara në buxhetin e përgjithshëm të miratuar për projektin;
- janë të nevojshme për zbatimin e projektit;
- ato janë të identifikueshme dhe të verifikueshme, të rregjistruara në regjistrat kontabël të Përfituesit dhe të përcaktuara sipas standardeve të kontabilitetit dhe praktikave të zakonshme të kontabilitetit të koston të zbatueshme për Përfituesin(ët);
- pagesa me para në dorë do të lejohen vetëm deri në një kufi maksimal prej 200 EUR;
- janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor dhe social në fuqi;
- janë të arsyeshme, të justifikuara dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit të shëndoshë financiar, veçanërisht në lidhje me ekonominë dhe efikasitetin.

Koston e papranueshme

Koston e mëposhtme nuk janë të pranueshme:

- borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi);
- dispozitat për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;
- interesi i borxhit (humbje nga llogaria bankare);
- koston e deklaruara nga përfituesi(të) dhe të financuara nga një tjetër projekt ose program që merr mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian (përfshirë EDF);
- blerjet e tokës ose ndërtesave;
- humbjet e këmbimit valutor;
- gjobat, gjobat financiare dhe shpenzime procesi gjyqësor;
- kontributet në natyrë;
- bonuse të përfshira në koston e personelit;
- interesi negativ i ngarkuar nga bankat ose institucionet e tjera financiare;



- kredi për palët e treta (jo të përfshira në komunitetin e grupit të synuar)
- kostot e pagave të personelit të administratave kombëtare;
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akcizat dhe taksat e tjera të veçanta të konsumit ose çdo taksë ose tarifë tjetër e ngjashme me efekt ekuivalent;

2.2 SI TË APLIKONI DHE PROCEDURAT QË DUHET TË NDIQNI

2.2.1 Dërgimi i aplikimit

Paketa e aplikimit duhet të dorëzohet në përputhje me udhëzimet e dhëna në këtë thirrje për propozime. Aplikimet duhet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet në formularin e aplikimit të grantit, bashkëngjitur këtij Udhëzuesi (Aneksi 1).

Aplikantët duhet të përgatisin dhe dorëzojnë aplikimin e tyre në **gjuhën shqipe**. Aplikimi i shkruar me dorë nuk do të pranohet.

Propozimi i projektit duhet të përgatitet duke ndjekur nga afër udhëzimet e aplikimit dhe formatet e publikuara (formularin e aplikimit, buxhetin). Prandaj është me rëndësi që këto dokumente të përmbajnë të gjithë informacionin në lidhje me projektin e propozuar.

2.2.2 Dokumentat mbështetëse

Aplikantët (aplikuesi kryesor dhe bashkë-aplikuesi, nëse ka) duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi:

- a) Aktin e Rregjistrimit në Gjykatë;
- b) Statutin e organizatës;
- c) Çertifikatën e rregjistrimit fiskal (NIPT);
- d) Dokument që pohon se organizata nuk ka detyrime financiare (Dokument i lëshuar nga e- Albania);
- e) CV e organizatës;
- f) Përfaqësuesi ligjor i Aplikantit Kryesor duhet të nënshkruajë dhe vulosë: Deklaratën e Aplikantit Kryesor (Aneksi 3); përfaqësuesi ligjor i bashkë-aplikuesit duhet të nënshkruajë dhe vulosë: Mandatin (Aneksi 4);

2.2.3 Ku dhe si të dërgoni aplikimin

Aplikimet duhet të dorëzohen në një version origjinal me madhësi A4.

Të gjitha dokumentet e paraqitura për aplikim duhet të dërgohen edhe në format elektronik (USB ose CD). Dosja elektronike e aplikimit duhet të përmbajë saktësisht të njëjzat dokumenta si versioni i printuar. Faqja e fundit e formularit të aplikimit duhet të ketë nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor të aplikantit kryesor dhe vulën e organizatës.

Zarfi i jashtëm duhet të ketë:

- Numrin e referencës së thirrjes për propozim (IPA III/2022/441-234)
- Titullin e thirrjes për propozime (Faza 1- Nëngrantet SPACE për të mbështetur OSHC-të lokale që veprojnë në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit)



Funded by
the European Union



- Emrin e aplikantit kryesor
- Adresën e aplikantit kryesor
- Fjalët: “*Të mos hapet para datës së hapjes zyrtare*”.

Aplikimet duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur me postë rekomandë, shërbim korrier privat ose dorazi (një mandat i nënshkruar dhe me datën përkatëse do t'i jepet dorëzuesit të aplikimit) në adresën e mëposhtme:

Adresa postare:

Together for Life

Rr. Brigada VIII, Pallati Jeshil Tekno-Projekt, Hyrja 2, Ap.14,

Tiranë/ Shqipëri

Aplikimet e dërguara me mjete të tjera (p.sh. me email) ose të dorëzuara në adresa të tjera do të refuzohen.

2.2.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikimit

Afati i fundit për dërgimin e aplikimit është 19 Dhjetor 2023, siç dëshmohet nga data e dërgimit, vula postare ose data e depozitimit. Në rastin e dërgesave dorazi, afati i fundit për marrjen e aplikimeve është ora 17:00, siç dëshmohet nga mandati i nënshkruar dhe data e saj. Çdo aplikim i dorëzuar pas këtij afati do të refuzohet.

2.2.5 Informacione të tjera rreth aplikimit

Pyetjet mund të dërgohen me email jo më vonë se 10 ditë përpara afatit të fundit të dorëzimit të aplikimeve në adresën e mëposhtme të emailit, duke treguar qartë titullin e thirrjes për propozime.

Adresa e emailit: grants@togetherforlife.org.al

Together for Life (TFL), si autoriteti nën-grantues nuk ka asnjë detyrim të japë sqarime për pyetjet e marra pas kësaj date. Për të siguruar trajtim të barabartë të aplikantëve, TFL nuk mund të japë një opinion paraprak për përshtatshmërinë e aplikantëve, një veprim ose aktivitete specifike.

Pyetjet që mund të jenë të rëndësishme për aplikantët e tjerë, së bashku me përgjigjet, do të publikohen në faqen e TFL: www.togetherforlife.org.al. Për të qëndruar të informuar në lidhje me pyetjet dhe përgjigjet e publikuara, ju këshillojmë që të vizitoni rregullisht faqen e internetit të TFL.

2.3 VLERËSIMI DHE PËRZGJDHJA E APLIKIMEVE

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga një komision vlerësimi, i përbërë nga vlerësues të jashtëm. Të gjitha aplikimet do të vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve të mëposhtme.

Hapi 1: Kontrolli administrativ

Gjatë hapjes dhe kontrollit administrativ, komisioni vlerësues do të vlerësojë nëse është respektuar afati i dorëzimit dhe nëse formulari i aplikimit plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në listën e kontrollit të administruar.

Kriteret Administrative	Po	Jo	Komente
1. Propozimi është dorëzuar brenda afatit.			
2. Janë përdorur formularët e aplikimit të publikuara në udhëzimin e thirrjes për projekt propozime (<i>të shtypura, në gjuhën shqipe</i>)			
3. Përfshihet një version origjinal i printuar i dokumenteve.			
4. Një version elektronik i propozimit është bashkangjitur (në USB ose CD)			
5. Të gjitha dokumentet mbështetëse janë dorëzuar në formën e kërkuar.			
6. Aplikanti është një OSHC/OJQ e regjistruar dhe që vepron në territorin e Shqipërisë.			
7. Granti i kërkuar është në përputhje me pragun e përcaktuar (deri në 9000 EUR).			
8. Kohëzgjatja e projektit është jo më pak se 6 muaj dhe jo më shumë se 9 muaj.			

Pasi Komisioni i Vlerësimit të përfundojë vlerësimin e këtij hapi, të gjithë aplikantët kryesorë do të njoftohen me e-mail për rezultatet e Hapit 1.

Hapi 2: Vlerësimi i aplikimeve

Cilësia e aplikimeve, duke përfshirë buxhetin e propozuar dhe kapacitetin e aplikantëve, do të vlerësohet duke përdorur kriteret e vlerësimit në kornizën e mëposhtme.

Struktura e vlerësimit është e ndarë në seksione dhe nënseksione. Çdo nënseksion do t'i jepet një vlerësim midis 1 dhe 5 si më poshtë: 1 = shumë i dobët; 2 = i varfër; 3 = adekuate; 4 = mirë; 5 = shumë mirë.



Seksioni	Pikëzimi maksimal
1. Kapaciteti operacional	5
1.1 A kanë aplikantët dhe, nëse është e aplikueshme, bashkëaplikuesit e tyre përvojë të mjaftueshme në menaxhimin e projekteve?	5
2. Relevanca	30
2.1 Sa i përshtatshëm është propozimi me objektivin dhe prioritetet e thirrjes për propozime dhe temat/sectorët/fushat specifike apo ndonjë kërkesë tjetër specifike të përcaktuar në udhëzuesin për aplikantët? A janë rezultatet e pritshme të projektit në përputhje me prioritetet e përcaktuara në udhëzuesin për aplikantët?	5x2*
2.2 Sa i përshtatshëm është propozimi me nevojat dhe kufizimet e veçanta të sektorëve të shëndetësisë dhe arsimit?	5x2*
2.3 Sa qartë janë përcaktuar dhe zgjedhur në mënyrë strategjike ata që janë përfshirë (përfutuesit përfundimtarë, grupet e synuara)? A janë përcaktuar qartë nevojat/ pengesat e tyre dhe a i adreson projekt propozimi ato në mënyrë të përshtatshme?	5
2.4 A përmban propozimi elemente të veçanta me vlerë të shtuar (p.sh. inovacion, praktika të mira)?	5
3. Draftimi i projektit	25
3.1 Sa koherent është draftimi i projektit? A tregon propozimi rezultatet e pritura që do të arrihen?	5
3.2 A pasqyron draftimi i projektit një analizë të qartë të problemit?	5
3.3 A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhje me rezultatet e parashikuara? A është realist afati kohor i përcaktuar?	5
4. Qëndrueshmëria e projektit	10
5.1 A ka gjasa që projekti të sjellë një ndikim real në grupet e synuara?	5
5.2 A ka gjasa që veprimi të ketë efekte shumëfishë, duke përfshirë mundësinë për replikim, zgjerim, kapitalizim të përvojës dhe ndarjes së njohurive?	5
5. Buxheti dhe kosto-efektiviteti i aktiviteteve	10
6.1 A janë pasqyruar siç duhet aktivitetet në buxhet?	5
6.2 A është i kënaqshëm raporti ndërmjet kostove të vlerësuara dhe rezultateve?	5
Vlerësimi maksimal	80

* Këto pikë shumëzohen me 2 për shkak të rëndësisë së tyre

Pas vlerësimit, do të hartohet një tabelë ku do të renditen aplikimet sipas pikëve të tyre. Aplikimet me pikët më të larta do të zgjidhen përkohësisht derisa të arrihet buxheti i disponueshëm për këtë thirrje për propozime. Gjithashtu, një listë rezervë do të hartohet sipas të njëjtave kritere. Kjo listë



do të përdoret nëse më shumë fonde vihen në dispozicion gjatë periudhës së vlefshmërisë së listës rezervë.

Hapi 3: Vlerësimi final dhe vendimmarrja

Komisioni i Vlerësimit do të marrë vendimin përfundimtar dhe rezultatet e procesit të vlerësimit do t'u komunikohen zyrtarisht aplikantëve.

Autoriteti Nën-grantdhënës, para nënshkrimit të kontratës, rezervon të drejtën për të negociuar me aplikantët në mënyrë që të sigurojë efikasitetin e kostos së veprimit, të sigurojë një ekuilibër të drejtë midis kostove operacionale dhe jo-operative, të pasqyrojë kostot reale të tregut dhe të pasqyrojë kostot në përputhje me aktivitetet e propozuara.

Pas arritjes së marrëveshjes, kontrata e nën-grantit do të nënshkruhet ndërmjet aplikantit përkatës dhe autoritetit kontraktor - Together for Life.

Hapi 4: Njoftimi i vendimit të autoritetit nën-grantdhënës

Aplikantët kryesorë do të informohen me e-mail për vendimin e autoritetit kontraktor në lidhje me aplikimin e tyre dhe, nëse refuzohet, për arsyet e vendimit negativ. Ju lutemi vini re se aplikanti kryesor është ndërmjetësi për të gjitha komunikimet ndërmjet aplikantëve dhe autoritetit kontraktor gjatë procedurës.

Apelimi

Pa paragjykim, kur një aplikant beson se ai është cënuar nga një gabim ose parregullsi e supozuar e kryer si pjesë e procedurës së përzgjedhjes, ose procedura është dëmtuar nga ndonjë keqadministrim, mund të paraqesë një ankesë brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita kur emaili i refuzimit është marrë.

Komisioni vlerësues i përgjigjet ankesës së paraqitur jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga marrja e ankesës. Përgjigja e ankesës paraqet vendimin përfundimtar lidhur me aplikimin.

3. AFATET INDIKATIVE TË PROCESIT

AFATET E SUGJERUARA	
	DATA
1. Hapja zyrtare e thirrjes për projekt propozime	20 Nëntor 2023
2. Afati i fundit për të kërkuar sqarime nga Autoriteti kontraktues	9 Dhjetor 2023

3. Afati i fundit në të cilën Autoriteti Kontraktues kthen përgjigje për pyetjet e marra.	11 Dhjetor 2023
4. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve.	19 Dhjetor 2023, ora 17.00
5. Informimi i aplikantëve kryesorë për kontrollin administrative dhe kriteret e pranueshmërisë.	28 Dhjetor 2023
6. Informimi i aplikantëve kryesorë mbi vlerësimin e aplikimit të plotë.	17 Janar 2023
7. Njoftimi i fitueseve.	19 Janar 2023
8. Firmosja e kontratës.	30 Janar 2023

LISTA E ANEKSEVE

Aneksi 1: Formulari i aplikimit (format word)

Aneksi 2: Buxheti (format Excel)

Aneksi 3: Deklarata nga Aplikanti Kryesor

Aneksi 4: Mandati nga Bashkë-aplikanti